

VENDIM
Nr.8, datë 25.4.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“““
Ve'li Budo,	Anëtar i	“““
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Halil Kopani,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““

me sekretare Drita Filto, me datë 19.3.1997 dhe 2.4.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.12 Akti që u përket:

KËRKUES: QEMAL SELMANI, i përfaqësuar nga Av.Spiro Peçi e Kristaq Traja.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. MINISTRIA E PRIVATIZIMIT , në mungesë
2. MINISTRIA E FINANCA VE, në mungesë.

O B J E K T I:

Deklarimi i papajtueshmërisë me ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish pronarëve" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.8.1995, pika 4.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi palën kërkuese, si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VEREN:

Kërkuesi Qemal Selmani në kërkesën e tij ka parashtruar se pika 4 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.8.1995 "Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare", vjen në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", sepse ju mohon ish-pronarëve të trojeve të zëna me objekte, të drejtën e parablerjes në rastet e privatizimit të tyre.

Sipas kërkuesit, ky vendim i ka prekur atij të drejtën e parablerjes së kantinës së verës "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Durrës, e cila gjendet në truallin që i është njohur si ish-pronë e tij, objekt i cili po privatizohet nëpërmjet ankandit të aksioneve.

Në radhë të parë, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të verë në dukje se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.8.1995, objekt kërkesë, është shfuqizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.759, datë 11.11.1996. Por, meqënëse edhe në Vendimin nr.759 pozita e ish-pronarëve të trojeve, në raport me objektet që privatizohen është e njëjtë si në vendimin e parë, Gjykata mori si objekt shqyrtimi vendimin e ri.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.759, datë 11.11.1996 "Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare", në pikën 4 ju njeh ish-pronarëve të trojeve të drejtën të marrin aksione në shoqëritë që privatizohen në përpjestim me vlerën e trojeve të njohura. Për më tepër, për të ruajtur interesat e tyre, përqëndja e aksioneve që ju jepet në formë kompensimi mbetet e pandryshuar në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.

Veç kësaj, vendimi i mësipërm, nuk privon ish-pronarët e këtyre trojeve të marrin pjesë në ankand për pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë.

Një rregullim i tillë juridik i të drejtave të ish-pronarëve nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993.

Përkundrazi, në frymën e nenit 16 të këtij ligji dhe me synim krijimin e lehtësirave për ato, parashikon një kompensim të ish-pronave të tyre. Nga ana tjetër, ç'ka është më kryesorja, rregullimi juridik i parashikuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.759, datë 11.11.1996 nuk bije në kundërshtim as me nenin 21 të ligjit të mësipërm, ashtu siç pretendohet.

Nga analiza e nenit 21 del se ligjvënësi për kohën kur u miratua ligji, kishte parasysh ruajtjen e së drejtës së parablerjes për ish-pronarët në rastin e privatizimit të pronës shtetërore në formën e objekteve të vogla e të mesme si psh., dyqane, magazina, punishte dhe objekte të tjera të kësaj madhësie e vlere. Nga ana tjetër, e ç'ka ishte më e rëndësishme, e drejta e parablerjes njihet kur privatizimi i këtyre objekteve do të bëhej "me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi". Është fakt që në një sërë aktesh nënligjore që dolën në bazë e për zbatim të ligjit u ruajt e drejta e parablerjes të ish-pronarëve e veçanërisht në privatizimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndërmarrjet e transformuara kaluan në një rregjim tjetër juridik, të rregulluar nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare". Në ato shteti paraqitej si ortak ose aksionist i vetëm. Në këto kushte, privatizimi i tyre në tërësi ose i një pjese (pakete) aksionesh nuk është privatizim objekteve konkrete, por shitje aksionesh e për pasojë aksioneri i vetëm, në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare", mund t'i shesë lirisht ato pa qenë i lidhur nga ndonjë kusht siç është ai i parablerjes.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 26 e vijuese të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njezëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.
- Urdhërohet heqja e pezullimit të ankandit të Kantinës së Pijeve "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Durrës.

Tiranë, më datë 25.4.1997